

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-186/14**

**Prishtinë,  
27 prill 2016**

Në çështjen juridike të  
**S. M.N.**

***Pala ankuese***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, si kryetar i kolegjit, gjyqtarët Anna Bednarek dhe Beshir Islami anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/223/2013 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA22035), të datës 27 nëntor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 27 prill shkurt 2016, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga S. M. N. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/223/2013, e datës 27 nëntor 2013, refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/223/2013, i datës 27 nëntor 2013, në lidhje me kërkesën e regjistruar në AKP me numër KPA22035.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 19 janar 2007, pala ankuese S.M.N. (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit, (tani e tutje: AKP), me të cilën ka kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore të tij dhe ri-posedimin e ngastrës së tokës nr. 315, me lokacion në rrugën Breg Kod Stanice, me listë të posedimit nr. 58, Zona Kadastrale Bablak, Komuna e Ferizajt (tani e tutje: prona e kërkuar). Ai pretendon se pronën e kërkuar e kishte humbur më 14 qershor 1999.
2. Bashkë me kërkesën e tij, pala ankuese ka paraqitur në AKP kopjen e listës poseduese nr. 58, të lëshuar nga Qendra Kadastrale për Patundshmëri e Ferizajt, Republika e Serbisë, më 17 janar 2002, me emrin e tij si pronar i pronës së kërkuar.
3. Lënda është regjistruar me numër KPA22035.
4. Sipas raportit të verifikimit të datës 30 mars dhe 13 gusht 2007, AKP-ja ka vërtetuar *sipas detyrës zyrtare* listën poseduese nr. 58, të lëshuar nga Departamenti për Kadastër në Komunën e Ferizajt më 20 mars dhe 8 gusht 2007 (tani e tutje: lista e re poseduese). Megjithatë, lista e re poseduese me emër të palës ankuese nuk përmban pronën e kërkuar (ngastra kadastrale nr. 315). Përveç kësaj, AKP-ja ka vërtetuar *sipas detyrës zyrtare* edhe listën poseduese nr. 195, të lëshuar nga Departamenti për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë i Komunës së Ferizajt që përmban pronën e kërkuar (ngastra kadastrale nr. 315) të regjistruar në emër të Ndërmarrjes Shoqërore (tani e tutje: NSH) “Pasuri Bujqësore”.
5. Më 18 gusht 2008, ekipi i AKP-së për notifikim ka bërë njoftimin pronës së kërkuar dhe ishte kosntatuar se ajo ishte tokë e papunuar, dhe askush nuk i është përgjigjur kërkesës. Më 22 shkurt 2010, AKP-ja ka konfirmuar lokacionin e mëparshëm duke vërtetuar se prona ishte identifikuar saktë.
6. Më 27 nëntor 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (tani e tutje: KKPK), përmes vendimit të vet KPCC/D/R/223/2013 (tani e tutje: vendimi i KKPK-së) ka hedhur poshtë kërkesën. Në arsyetimin e vendimit (paragrafi 20), KKPK-ja nënvizoi se pala ankuese nuk ka arritur të tregojë se kërkesa e tij përfshin rrethana që lidhen drejtpërdrejt ose që janë rezultat i konfliktit të viteve 1998-99, prandaj kërkesa është jashtë mandatit të KKPK-së.

7. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 23 maj 2014. Më 30 maj 2014 pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së.

### **Pretendimet e palëve**

8. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës ta pranojë ankesën e tij dhe ta caktojë ri-posedimin e pronës së kërkuar. Në ankesë ai tregon se vendimi i KKPK-së mbështetet në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe në zbatim të gabuar të ligjit material.
9. Sipas mendimit të palës ankuese prona e kërkuar ka qenë pronë e familjes së tij që nga viti 1965, dhe se pronën e kishte trashëguar dhe regjistruar në emrin e tij pas vdekjes së babait të tij. Ai pohon se babi i tij – sipas kontratës mbi këmbimin - “këmbeu “ njërën nga ngastrat e tij, fushën e pojatës, me sipërfaqen prej 24 ari me pronën e kërkuar. Ai shton se kontratën në fjalë e ka poseduar deri më 1999, kur u detyrua të ikë në Serbi, kështu që ajo është djegur “me shtëpinë dhe të gjitha objektet përcjellëse të cilat më pas ishin shkatërruar dhe djegur”.
10. Pala ankuese pretendon se është krejtësisht i pavërtetë konstatimi i KKPK-së se ai kurrë nuk ishte në posedim të pronës së kërkuar dhe se nuk e ka humbur të drejtën e tij për shkak të konfliktit të armatosur. Ai shton se prona e kërkuar ka qenë në posedimin e tij deri më qershor 1999, kur u detyrua të ikë nga Kosova bashkë me familjen e tij.
11. Në fund, pala ankuese tregon se dokumentet e paraqitura, të bashkangjitura ankesës së tij, qartazi vërtetojnë se e kishte pronësinë dhe posedim të ligjshëm mbi pronën e kërkuar, dhe prandaj të drejtën e kishte humbur për shkak të rrethanave “të konfliktit të armatosur të ndodhur në mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999”.

### **Arsyetimi ligjor**

12. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se vendimi i apeluar i KKPK-së është i plotë dhe gjendja faktike e tij është vërtetuar drejt dhe mbi këtë bazë si ligji material ashtu edhe ai procedural janë zbatuar drejt. Prandaj, ankesa refuzohet si e pabazuar.
13. Pala ankuese pretendon se prona e kërkuar ishte në pronësi të familjes së tij që nga viti 1965, kur “babai i tij i ndjerë kishte këmbyer njërën nga ngastrat e tij, fushën e pojatës, me sipërfaqen prej 24 ari” për pronën e kërkuar (ngastra kadastrale nr. 315). Pala ankuese nuk e ka dorëzuar në AKP kontratën mbi këmbimin, në bazë të së cilës pronat pretendohet të ishin këmbyer. Sipas palës ankuese, arsyeja për këtë është se kontrata ishte djegur bashkë me shtëpinë e tij si pasojë e rrethanave të konfliktit të vitit 1998/1999.
14. Në mbështetje të mëtejme të pretendimeve të tij, pala ankuese ka siguruar listën poseduese nr. 58, të lëshuar nga Qendra Kadastrale për Patundshmëri e Ferizajt, Republika e Serbisë, më 17 janar 2002, me emrin e tij si pronar i pronës së kërkuar.
15. Në bazë të raportit të verifikimit të datës 30 mars dhe 8 gusht 2007, ekipi i AKP-së për notifikim ka siguruar (një tjetër) listën e re poseduese (me numër të njëjtë), të lëshuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (tani e tutje: UNMIK) – Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Ferizajt, më 20 mars dhe 8 gusht 2007.

16. Lista e re poseduese tregon emrin e palës ankuese si pronar të disa ngastrave (sikurse: 164, 550, 610, 773/2, 785/1, 788/1 dhe 881), por nuk përmban pronën e kërkuar (ngastrën kadastrale nr. 315) e cila është objekt shqyrtimi i kontestit në fjalë.
17. Përveç kësaj, Përveç kësaj, AKP-ja ka vërtetuar *sipas detyrës zyrtare* edhe listën poseduese nr. 195, të lëshuar nga UNMIK-u, Departamenti për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë i Komunës së Ferizajt e cila emëron NSH-në “Pasuri Bujqësore” si pronar të pronës së kërkuar, e jo palën ankuese.
18. Gjykata Supreme pohon se KKPK-ja ka shqyrtuar dhe vlerësuar drejt provat. Sipas mendimit të gjykatës, dokumenti i dorëzuar nga pala ankuese nuk e vërteton të drejtën e tij pronësore dhe humbjen e posedimit të pronës së kërkuar si rezultat i rrethanave të konfliktit të armatosur që ka ndodhur në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
19. Gjykata Supreme mendon se pala ankuese nuk ka vërtetuar se ka pasur bazë ligjore për posedim të pronës së kërkuar. Nuk ka dorëzuar asnjë dokument për ta vërtetuar këtë rrethanë. I vetmi dokument që është dorëzuar në KKPK ishte lista poseduese e lëshuar nga një institucion paralel në Republikën e Serbisë më 2002. Në fletën poseduese tjetër nr. 58 dhe se lista poseduese nr. 195 në fakt përmbante ngastrën e kërkuar, por që tregonte Ndërmarrjen Shoqërore si pronar të tokës, pala ankuese e kishte për detyrë të dorëzonte prova që do të vërtetonin bazën e tij të kërkojë ri-posedimin e ngastrës nr. 315.
20. AKP-ja ka kontaktuar palën ankuese, e ka njoftuar lidhur me faktin dhe kërkoj të dorëzohen provat brenda një afati të caktuar. Afatet kanë skaduar dhe pala nuk ka dorëzuar asnjë provë shtesë. Mos vërtetimi i rrethanave me rëndësi në interes të palës ankuese, sipas nenit 319 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, rezulton me arritjen në përfundim se pala nuk ka vërtetuar se me të vërtetë ka bazë ligjore në pronë e kërkuar.
21. Për më shumë, Gjykata Supreme konsideron se pala ankuese nuk ka arritur të vërtetojë se ka humbur posedimin e pronës së kërkuar për shkak të konfliktit të armatosur. Me rastin e kontaktimit të tij nga AKP-ja më 10 nëntor 2013 pala ka pohuar se humbja e posedimit kishte ndodhur në vitin 1983 përmes shpronësimit dhe prej atëherë asnjëherë nuk e ka shfrytëzuar ngastrën e kërkuar. Rrjedhimisht, në ankesë pala ka përmendur se në fakt kishte humbur posedimin më 14 qershor 1996 kur kishte ikur nga Kosova. Deklaratat e palës ankuese nuk janë koherente: janë kundërthënëse njëra me tjetrën. Duke marrë parasysh faktin se certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme të cilën AKP-ja e ka gjetur *sipas detyrës zyrtare* përmend Ndërmarrjen Shoqërore si pronar të ngastrës, Gjykata Supreme pohon se e drejta pronësore e palës ankuese ndaj ngastrës së tokës nr. 315 nuk mund të shihet si e vërtetuar.
22. Të gjitha elementet e përmendura më lart qojnë Gjykatën Supreme deri te përfundimi se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë për arsye të duhura kur ka hedhur poshtë kërkesën e palës ankuese. Në përputhje me nenin 3.1 të Ligjit 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër nga KKPK-ja për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që vërteton pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe nëse ai ose ajo nuk ka mundësi ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore për arsye të lidhura drejtpërdrejt ose si pasojë e konfliktit të armatosur të ndodhur në Kosovë në mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

23. Rrjedhimisht, në bazë të ligjit të aplikueshëm drejt, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ankesa e palës ankuese refuzohet si e pabazuar dhe vendimi i apeluar i KKKPK-së konfirmohet si i drejtë.

*Konstatim*

24. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në bazë të nenit 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenit 195, paragrafit 1(d) të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

25. Ky aktgjykim nuk paragjykon të drejtën e palës ankuese për ta drejtuar lëndën e tij në gjykatën kompetente jashtë juridiksionit të paraparë me dispozitat e nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

**Këshillë juridike**

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Beshir Islami, Gjyqtar**

**Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it**

**Sandra Gudaityte, referente e EULEX-it**